

Dt 04.03.2021

STATUT I SHOQËRISË "ELECTRIC COMMON POLE" shpk

Ne perputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, "Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare",
Ligji Nr. 131/2015 PER "QENDRËN KOMBETARE TË BIZNESIT"

KREU I

Neni 1

Emërtimi

Shoqëria do te emërtohet "ELECTRIC COMMON POLE" shpk dhe eshte person juridik i te drejtes shqiptare.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqera fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria "ELECTRIC COMMON POLE" shpk eshte nje shoqeri tregtare e themeluar nga ortaku i vetem: ILIR LELO NAZËRAJ, lindur me 07/08/1985, ne Fier dhe banues ne Vreshtas, Njesia Administrative Cakran, Bashkia Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i identifikuar prej meje noterit me Leternjofim nr personal I50807051D, me nr. Kontakti:+355697294351.

Neni 3

Selia e Shoqërise

Shoqëria e ka seline ne Fier, Qendra administrative Cakran, Lagjja "Nazeraj" Nd.52; H. 1; Cakran; Vreshtas, Fier.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie , degë, te krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë , vetem me vendim te ortakut te vetem.

Neni 4

Objektivi i veprimtarise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushën:

Prodhimi i kontenierëve prej druri. Riparimi dhe Instalimi i makinerive dhe pajisjeve elektrike, Import dhe eksport, veprimtari e Instalimeve elektrike, Tregtim i artikuj te ndryshem industriale. Tregtimi me pakice dhe shumice e materialeve dhe artikujve industriale, hidraulike mekanike materiale te ndryshme ndertimi, metalike, elektrike dhe hidraulike dhe produktet e tyre.

Neni 5

Kohëzgjatja e Shoqerise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluat nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit .

ILIR NAZËRAJ



KAPITALI
Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise "ELECTRIC COMMON POLE" shpk eshte 100,000 (njëqind mijë) leke i ndare ne 1 pjese ne vlere 100,000 (njëqind mijë) leke. Ky kapitali do te ngurtesohet pasi shoqeria te jete regjistruar ne QKB. Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar nga ortaku i vetem i shoqerise:

Z. ILIR LELO NAZËRAJ, lindur me 07/08/1985, ne Fier dhe banues ne Vreshtas, Njesia Administrative Cakran, Bashkia Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i identifikuar prej meje noterit me Leternjofim nr personal I50807051D, qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjeset e kapitalit nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta). Kapitali do te paguhet ne banke menjehere pas regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit.


Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve ne masen 100 % te kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7
Zmadhimi dhe Zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve te kapitalit themeltar per kontributet në para dhe me anë te kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute ne natyrë sipas kërkesës se administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme ne te njëjtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit. Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së ortakeve të thimrrur për të marë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeletar ne një vlerë me të vogël sa ajo e përcaktuar në nenin 6 te këtij statuti, e ben te detyrueshëm marrjen e nje vendimi prej shoqerise peër zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri ne vleren minimale. Në rast mosbesimi te kerkesave te këtij paragrafi, çdo personi insistuar mund te kërkoje ne rruge gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund te shpallet, në qofte se rregullimi eshte bere ne ditën kur ghykata mblidhet per te marre vendimin.

ILIR NAZËRAJ


Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqërie me pergjegjësi te kufizuar e të drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuotën dhe ai qe fiton atë përgjigjen ne mënyrë solidare ndaj shoqërisë per detyrimet qe rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombetare të Biznesit. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themelar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i shoqerise.

Asambleia e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme, vendos për çështje si;

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve konabël të autorizuar;
- ç) parcaktimin e shpërbilimeve.
- d) mbikëqyren e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, pëfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtrtisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve të asamblesë.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për;

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i Kundrejtoje pavlefshmërinë të tretit, qe ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

ILIR NAZERAS

Neni 10
Administrimi

Administrator i shoqërisë "ELECTRIC COMMON POLE" shpk është Z. ILIR LELO NAZËRAJ, lindur me 07/08/1985, në Fier dhe banues në Vreshtas, Njesia Administrative Cakran, Bashkia Fier, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar i identifikuar prej meje noterit me Letërnjoftim nr personal I50807051D, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje, duke filluar prej datës 04 Mars 2021 deri në 03 Mars 2026.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut të vetern të shoqërisë.

Neni 11
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblësë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe në rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajëve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë me të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

Administratori përfaqëson shoqërinë përpara gjithë personave fizik dhe juridik, publik dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritete gjyqësore të të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretë nepermjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

ILIR NAZËRAJ



Neni 12
Përgjegjësitë


Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkelje të Ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të këtyre gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrvëshjeve të pamiratuara nga Asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrvëshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detytohet:

- 1) a) të kryejë detyrat e tij të percaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçante ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
b) të ushtroj kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të percaktuara në këto dispozita;
c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
ç) të parandalojë dhe tmënjanojë rastet e konfliktit, present apo të mundshme, të interesave personalë me ato të shoqërisë;
d) të ushtroj detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
- 2) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 3) Nëse administrator vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshperblej shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe të kaljë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barren e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt sipas standardeve të kërkuar. Kur shkelaj është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
- 4) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administrator është i detyruar t'i dëmshperblej shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit. Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:
 - a. U kthen ortakëve kontributet,
 - b. U paguan ortakëve interesat apo dividendë,
 - c. U shperndan aktivitet shoqërisë,
 - ç. Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet,
 - d. Jep kredi.

Neni 13

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor

ILIR NAZERRI


Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Pergjithshme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori. Mbledhja e ortakëve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertët

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloj te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate vjetir dhe ate ne lidhje me kontrollet perkatese te ushtruar perj tij per rastet kur aii eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodic te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakevet per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

EKSPERT KONTABEL (KONTABEL I MIRATUAR) i shoqerise do te zgjidhet gjate ecurise se shoqerise.

Neni 16

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas veçimit te fondeve ligjore te mësipërme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin pagesave ndaj te tretëve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve te shoqerise.

Neni 17

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :


- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e sai;
- b) me vendim te ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryet veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me nenet perkatese te ligjit "Per Qendren Kombetare te Biznesit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast ortakët merrin vendime me shkim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxierre prej tyre emrin e likuidatorit dhe emrtesën shtese "Shoqeri ne likuidim e sipër".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Pergjithshme.

Nese Asambleja nuk merr nje vendim per emërimin e likuidueseve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person I interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

ILIR NAZIRAJ


Neni 18

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emërimit te tij. Nese shoqeria emëron me shume se nje likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetërit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht te drejtat e detyrimetsipas këtij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryej veprime ten je kategorie te posaçme, Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te tretëve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes se Asambles dhe Administratorit.

Neni 19

Te drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkatuara dhe e kontributeve te Pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbyllien e nje veprimi të papërfunduar.
3. Nese ne baze te padive te ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", likuiduesit verejne se pesuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e Pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne procedure e likudimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi pergatit nje balance te gjendjes se shoqerise ne çastin e hapjes se likudimit dhe nje bilanc perfundimtar ne çastin e mbylljes se ketyre procedurave. Nëse proceduar e likudimit zgjat me shume se nje vit, likuduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise, Bilancet ne shoqerine kolektive dhe komandite miratohen nga Asambleja e Pergjithshme, ndersa ne shoqerite aksionere apo nga ato me pergjegjesi te kufizuar miratohen nga asambleja e pergjithshme.

Neni 20

Perfundimi i likudimit

pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombëtare te Biznesit per perfundimin e likudimit dhe kerkon çregjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Per Qendrën Kombëtare te Biznesit"

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njerës ose me shume prej shoqerive, qe quhen shoqerite e perthithura, te nje shoqeri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqeria përthithëse, ne kembim te aksioneve apo kuotave te kesaj shoqerie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerive ekzistuese, qe bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuotave te shoqerise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim i nje shoqërie të re.

ILIR NAZARAI



Neni 22

Ndarja

1. Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te ortakeve, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 te ligjit 9901 datë 14.04.2008.

3. Shoqerite, qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet, quhen shoqeri pritëse dhe pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.

a. Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ka si pasojë: Kalimin te shoqerite pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin endarjes, te percaktuar ne marrveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marrëdhëniet ndermjet shoqerive si dhe per palet e treta;

bërja e aksionarëve/ortakëve te shoqerise qe ndahet aksionarë apo ortakë ten je ose me shume shoqerive pritese, ne perputhje me raportin e ndarje, percaktuar ne marrëveshjen e ndarjes; vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit pa kryerjen e likudimit.

Neni 23

Shndërrimi

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderrimit te saj ne shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet , qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

Neni 24

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 25

Mosmarrveshjet

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 2 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlere te njejta juridike. Dhe pasi iu lexua ortakeve, nenshkruhet me vullnetin e tyre te lire nga ortaket themelues

ORTAKU I VETËM

ILIR NAZËRAJ

ILIR NAZËRAJ

